



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 09 dhjetor 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj dhe Afrim Hoti.

Munguan: Adem Grabovci dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës) – Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.11.2011.
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2010.
4. Shqyrtimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit, në bazë të Vendimit të Kuvendit, lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2010.
5. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.11.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2010

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit se kryetari i Gjykatës Kushtetuese nuk do të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit, pavarësisht ftesës së dërguar me kohë. Para Komisionit do të prezantoj sekretarja e Gjykatës Kushtetuese. Para këtij Komisioni kanë prezantuar zëvendëskryeministrat, avokati i popullit etj. Komisioni i ofron mundësi përfaqësuesve të institucioneve që të japin komentet e tyre lidhur me të gjeturat e ZAP-it, para se raporti të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare. Kërkoj mendimin e anëtarëve të Komisionit lidhur me këtë.

Ramiz Lladrovci – Tha se Komisioni duhet të vazhdojë shqyrtimin e Raportit dhe ta procedoj çështjen në mbledhje plenare. Është vendim i Komisionit që para tij të prezantoj përfaqësuesit më të lartë të institucioneve. Të gjitha rekomandimet e ZAP-it janë adresuar për kryetarin e gjykatës.

Valbona Dibra – Propozoi që Komisioni ta shtyjë këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen tjetër të Komisionit.

Bali Muharremaj – Ndau mendimin me anëtarët e tjerë të Komisionit, sepse praktika e Komisionit nuk mund të ndryshoj. Është vendim i Komisionit se kush duhet të prezantoj para tij dhe duhet respektuar atë.

Armend Zemaj – Sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kryetari i Gjykatës është hierarkia dhe menaxheri kryesor që ka të bëjë me financa. Ndau mendimin me anëtarët e Komisionit që raporti të shqyrtohet pa praninë e përfaqësuesit të Gjykatës Kushtetuese dhe raporti t'i procedohet mbledhjes plenare. Para këtij Komisioni kanë prezantuar shumë përfaqësues të institucioneve që janë kategori kushtetuese. Raportet e ZAP-it janë raporte ligjore dhe kujdesemi që tu japim mandat për të kryer detyrën por jo për t'i bërë "mbretër".

Afrim Hoti – Ishte i mendimit që para Komisionit duhet të prezantojnë njerëzit më kompetent, ndërsa për vitin tjetër Komisioni duhet të shqyrtoj vendimin e tij lidhur me këtë.

Lars Lage OLOFSSON - Në Kosovë ka rreth 30 institucione të pavarura. Kryetarët e këtyre institucioneve emërohen nga Kuvendi. Këta persona janë përgjegjës para Kuvendit. E njëjta është e për atë se çka raporton Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Pra në raportin e tij ai i përgjigjet parlamentit se si e ka kryer punën e tij. Kjo është hera e dytë që prezantohet një raport i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Kuvendi jep këtij personi para për të kryer një punë shumë të rëndësishme. Ai mund të delegoj punët e përditshme te sekretari i përgjithshëm. Kjo është delegim i përgjegjësive të përditshme, por jo delegim i përgjegjësisë llogaridhënëse. P.sh; Në ZAP menaxheri që jep përgjegjësi është auditori i përgjithshëm. Të tjerët që punojnë në ZAP punojnë për auditorin e përgjithshëm dhe ai është përgjegjës dhe llogaridhënës para Kuvendit. Nuk mund të jetë ndryshe për kryetarin Gjykatës kushtetuese. Lidhur me këtë ZAP nuk ka gjetur bazë në ndonjë ligj apo në kushtetutë, se kryetari i Gjykatës Kushtetuese nuk përgjigjet para Kuvendit.

Arbëresha Shala, sekretare – Gjykata Kushtetuese – Në bazë të Kushtetutës neni 112 dhe

115, Ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe Ligjit për protokollin e shtetit Kryetari i Gjykatës Kushtetuese i cili përcakton rangun sipas të cilit, Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Kryetarin i Gjykatës Kushtetuese nuk ftohet në këto komisione. Ka pasur takim zyrtar lidhur me këtë me ZAP-in që adresimi i rekomandimeve të bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse që e ka bërë për Presidencën, Kryeministrin e dhe Kuvendin. Kjo është arsyeja se pse kryetari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka marrë pjesë në këtë takim. Gjykata vendos për buxhetin por zbatimi i tij bëhet nga sekretaria e Gjykatës.

Kryetari – Tha se Komisioni mbetet prapa vendimit të tij. Komisioni mund ta diskutoj këtë raport edhe vetëm me auditorin e përgjithshëm, por qëllimi është që të merret për bazë edhe mendimi i menaxherëve kryesor udhëheqës-bartës të institucioneve.

Ramiz Lladrovci - Komisioni shqyrton raportet e ZAP-it i thirrur për auditim në Gjykatën Kushtetuese. Rekomandimet janë adresuar për kryetarin e Gjykatës dhe si Komision fton menaxherin kryesor. Auditori i përgjithshëm është prezent dhe kërkoj koment nga ai. Kryetari i Gjykatës duhet të dëgjoj të gjeturat nga ky Komision.

Murselj Haljili- Ndau mendimin me kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Komisionit. sipas tij arsyetimi që prezantohet para Komisionit në mbledhje nga përfaqësuesit e Gjykatës është dashur të bëhen me shkrim. Domethënë të gjitha deklaratimet e përfaqësuesve të Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë të shkruara, pastaj Komisioni do të vlerësoj lidhur me të.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për shkak të mospjesëmarrjes së kryetarit të Gjykatës Kushtetuese në mbledhje te Komisionit, si dhe për faktin se duhet këshillë për nivelin e të ftuarve në mbledhje të Komisionit, njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

1. *Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.*
2. *Kërkohet nga Administrata e Kuvendit përkatësisht Departamenti Ligjor, që t'i paraqes këshillë ligjore Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për çështjet në vijim:*
 - *nëse Kryetari i Gjykatës Kushtetuese është personi përgjegjës llogaridhënës para Kuvendit.*
 - *cili është niveli i përfaqësimit të Institucioneve të Pavarura para Kuvendit - Komisioneve Parlamentare?*
 - *cili është niveli i përfaqësimit të Organizatave Buxhetore para Komisioneve Parlamentare?*

4. Shqyrtimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit, në bazë të Vendimit të Kuvendit, lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2010

Kryetari- Kërkoj mendimin e auditorit të përgjithshëm lidhur me raportin kthyes të IAP.

Lars Lage OLOFSSON ZAP ka dhënë raportin për IAP-in, në të cilin janë shpalosur një numër çështjesh. Një prej tyre ka qenë që IAP-i të ketë një plan veprimi rreth rekomandimeve të ZAP-it. IAP nuk ishte në gjendje të hartoj një plan të tillë. Ky institucion sikurse të gjitha OB duhet të hartoj pasqyrat financiare nëntëmujore dhe në një formë të veçantë duhet të thuhet në mënyrë specifike plani se si i kanë adresuar rekomandimet dhe faktet e parashikuara të tyre.

IAP nuk ka qenë në gjendje ta bëjë këtë. Në raport thuhet se ata pak a shumë do t'i adresojnë rekomandimet, përveç njërit ku ata nuk e kanë pikëpamjen siç e ka ZAP-i. Si pas tyre ZAP ka një perspektivë politike. Kjo nuk është e vërtetë. Ajo çka ka konstatuar ZAP-i është në pajtim të plotë me LSHC si dhe kornizën për menaxhim financiar dhe kontroll. Në këtë raport thonë që do të adresojnë rekomandimet, por që kjo varet shumë se sa burime kanë. Pra ata këtë e konsiderojnë si kërkesë buxhetore. IAP ka kufizime buxhetore që ja vlen të analizohen, por këto rekomandime mund të trajtohen pa marrë parasysh situatën buxhetore. ZAP ka kryer auditimin e ndërmjetëm dhe një memo ku japin këshilla për këtë institucion i është dërguar IAP-it dhe do t'i dorëzohet dhe këtij Komisioni.

Vlora Mehmenti- Faza e përkohshme e auditimit për IAP, ka përfunduar. 30 ditë pas auditimit përfundimtar OB është e obliguar që të dërgoj një PV për implementimin e rekomandimeve. IAP nuk ka bërë këtë dhe në pasqyrat nëntë mujore financiare nuk ka një plan të mirëfilltë. Materiali që i është dërguar KMFP nuk është plan që identifikon personat përgjegjës për implementim në afatin kohorë. Domethënë plani nuk është në përputhje me UA për raportim të jashtëm. Progresi i implementimit të rekomandimeve- ka progres vetëm në menaxhimin e prokurimit sa i përket furnizimit me mallra dhe shërbime. Të tjerat mbesin të pa-implementuara. Në pasqyrat nëntë mujore financiare janë shpalosur mangësi. ZAP ka dhënë këshilla përkatëse për secilin lëshim në pasqyra financiare. Ekzekutimi i buxhetit –donacionet- në fazën nëntë mujore janë shpenzuar vetëm 27% e donacioneve për paga dhe mëditje dhe një pjesë për mallra dhe shërbime. Ka mangësi te rekrutimi, shpalosja e pasurive nuk ka qenë në përputhje me UA nuk është kryer klasifikimi dhe shpalosja e vlerës në pasqyra financiare. Ka mangësi që janë has në menaxhimin e prokurimit. Faza e dytë do të jetë ajo që do të përcjell menaxhimin në katër muajt e fundit.

Valbona Dibra – Tha se në disa rekomandime IAP ka bërë vetëm një vlerësim të rekomandimeve, ndërsa në disa të tjera janë vërejtur edhe veprime konkrete.

Disa përgjigje janë të paqarta- rekomandimi një- për shpenzime komunale sa ka kërkuar IAP? Kjo len për të kuptuar se IAP nuk ka kërkuar 46 mijë euro për shpenzime komunale. Pastaj, në faqe tre - donacioni nuk është i drejtpërdrejtë - është i pakuptimtë. Komisionit i intereson se çka ndërmarrë IAP rreth zyrtarit të prokurimit? Këto gjëra duan sqarim dhe në mbledhje është dashur të ftohen edhe përfaqësues të IAP për tu përgjigjur për këtë raport kthyes.

Armend Zemaj –Në bazë të të gjeturave duhet të merren masa konkrete për të ndaluar keqpërdorimin dhe keqmenaxhimin e parasë publike. Janë dhënë disa përgjigje, por mbetet shumë për të dëshiruar. Komisionit i interesojnë masat që janë ndërmarrë, e në këtë rast nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret.

P.sh. “Për të gjitha proceset e prokurimit të kryera në pajtim me dispozitat ligjore dhe të gjeturat lidhur me këtë rekomandim është kërkuar përgjegjësi nga zyrtari për prokurim. Të gjitha procedurat e prokurimit janë përgjegjësi direktet e tij dhe në raste të shkeljeve do të merren masa sipas dispozitave në fuqi”. Sipas kësaj shkeljet që janë bërë në të kaluarën duhet harruar dhe duhet kujdesur vetëm për të ardhmen. Pastaj, “të gjitha llojet e kontratave për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi për shërbimet me restorante dhe ishin pjesë e të gjeturave për vitin 2010, janë shfuqizuar, ndërsa kontratat për vitin 2011 janë përgjegjësi vetëm e zyrtarit të prokurimit. IAP do të bëjë përpjekje shtesë që të arrihet marrëveshje bashkëpunimi me ndonjë institucion për auditim të brendshëm”. Ekziston NJAB që merret me këtë gjë dhe nuk ka nevojë bashkëpunimi me ndonjë institucion tjetër.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. *IAP ka bërë progres vetëm në një pikë, pjesa tjetër e rekomandimeve mbeten të pa-përmbushura.*
2. *IAP nuk ka një plan konkret me të cilin përcaktohen personat përgjegjës dhe afati kohor për përmbushjen e rekomandimeve.*
3. *Zyra e auditorit të përgjithshëm t'i dorëzoj memon që ka për këtë institucion dhe auditimin e këtij institucioni ta ketë prioritet për këtë sezon të auditimit.*
4. *Mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve, Komisioni do ta bëjë me raportin e radhës të auditimit nga ZAP-i.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu